



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3689 prot.

Fierzë, më 19.11.2025

PROCESVERBAL

TEMA: KONSULTIM PUBLIK MBI DRAFTIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE DARDHË-QEBIK NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 18 pika 1, pika 2, neni 54 germa (dh), germa (f) dhe në Rregulloren për Funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz (VKB Nr. 15, datë 27.04.2020) Neni 153, Neni 154, **u mbajt sot, më 19.11.2025, në ambientet e Njesisë Administrative Blerim, Ora:10:00, dëgjesa publike mbi projektvendimin "Për Miratimin e Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore "Dardhë-Qebik në Territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz"**

Në takim morën pjesë:

- 1. Mikel Qafa**, Zëvendëskryetar i Bashkisë
- 2. Naze Selimaj**, Sekretar për Këshillin Bashkiak
- 3. Ded Lleshi**, Specialist Kadastrë & GIS
- 4. Aleks Ndreka**, Përgjëgjës i IVMPK
- 5. Sokol Vata**, Specialist pyjore
- 6. Zef Zefi**, Specialist pyjore
- 7. Tonin Prenga**, Drejtor I Zyrës së Urbanistikës

Të pranishëm nga publiku në këtë dëgjese publike janë **banorët e Njesisë Administrative Blerim, të fshatrave Dardhë, Qebik, Truen, Blerim, Kulumri, Xath si dhe Kryetarë të fshatrave.**

Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, bën prezantimin e ekipit të bashkisë dhe të temës së diskutimit të dëgjeses publike mbi Draftin e Planit të Mbarështimit për Ekonominë Pyjore Dardhë-Qebik në Territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Fjalën hapëse e mbajti Administratori i Njesisë Administrative Blerim, **Z. Gjovalin Prendi** :



Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe në mënyrë të veçantë për dëgjesën publike të organizuar lidhur me mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave në zonën tonë.

Administratori i Njesisë Administrative, Z. Gjovalin Prendi e konsideron dëgjesën shumë të rëndësishme në mbështetje të nevojave për mbarështrim që kanë pyjet dhe kullotat në gjithë territorin e Njesisë Administrative Blerim.

Në vazhdim fjalën e merr **Z. Ded Lleshi**, Specialist Kadastre & GIS në Sektorin e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave:

Jemi këtu për të relatuar projektin, njëkohësisht edhe për të dëgjuar zërin tuaj me vëmendje dhe për të marrë mendimet dhe rekomandimet tuaja lidhur me mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave në Njësinë tuaj Administrative, kështu që ne plotësojmë planin e mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave për këtë zonë.



Z. Ded Lleshi, Specialist Kadastre & GIS në Sektorin e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave shpjegon se, mbarështimi i pyjeve është planifikimi afatgjatë për fondin pyjor, i cili në rastin konkret është bërë në bazë të kriterëve të caktuar për grumbullimin e informacionit për gjendjen faktike dhe përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme, në funksion të statusit të dhënë, me synim përmbushjen e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale, duke zbatuar dhe harmonizuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me nevojat e administruesve, pronarëve privat dhe përdoruesve të tyre. Plani i Mbarështimit të Ekonomisë pyjore Dardhë-Qebik, synon që të merren në konsideratë të gjithë faktorët që lidhen direkt ose indirekt ndërmjet tyre, popullata lokale, faktorët ekologjik dhe tokësorë, administrimi i pyjeve dhe kullotave, ekoturizmi, interesi që ofron pylli, blegtorët etj., pa harruar shërbimet në ekosistem që pylli ofron, të tilla si: kufizimin e erozionit, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujrave, ruajtjen e natyrës dhe qëndrueshmërinë e resurseve, mbrojtja e tokave bujqësore dhe infrastrukturës etj. Nga ana tjetër pylli përmbush edhe funksione të tjera si, plotësimi i nevojave me material drusor, bazë ushqimore për blegtorinë, si dhe përdorimi i prodhimeve të dyta pyjore përdorimi dhe përfitim i të cilave duhet bërë nëpërmjet një zhvillimi të qëndrueshëm të pyjeve.

Mbrojtja e ekosistemeve natyrore, përmirësimi i peisazhit rural dhe mbrojtja e biodiversitetit përbën një drejtim të rëndësishëm të projektit dhe zgjerimi i këtyre zonave do të jetë në qendër të objektivave të veçantë.

Gjithashtu një vend të veçantë zë harmonizimi i interesave të komunitetit dhe të pjesëmarrësve të tjerë veprues në territorin e kësaj ekonomie, në përputhje me mundësinë prodhuese aktuale dhe potenciale të pyllit.

Pyjet me funksion me funksion prodhues zënë 3630.2 ha ose 100 % të sipërfaqes pyjore. Grumbujt pyjorë të kësaj ekonomie qeverisen si më poshtë:

Ekonomia pyjore është me të njëjtin emër dhe ka patur një sipërfaqe totale prej 3898.45 ha, ndërsa me planin e ri dhe ndarjen e re territoriale kjo sipërfaqe arrin në 4308.5 ha.

Z. Lleshi Specialist Kadastrë & GIS në Sektorin e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave gjithashtu theksoi qëllimin dhe listoi objektivat e këtij plani:

Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështimit është rishikimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjorë.

Në objektivat e këtij plani mbarështimi një vend të rëndësishëm zë qëllimi primar *“sigurimi i një mbarështimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional i pyjeve”*. Gjithashtu, ky plan mbarështimi duhet të garantojë përdorim racional të burimeve natyrore pyjore dhe kullosore, si dhe të kontribuojë në cilësinë e jetesës në zonën rurale.

Objektivat e projektit të ri janë prezantuar tek të gjithë aktorët, duke e organizuar punën për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore.

Objektivat e planit të mbarështimit u hartuan në mbështetje të ligjit për zhvillimin e sektorit pyjor, ligji kuadër 57/2020 “Për pyjet” dhe në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për pyjet në Bashki, popullatën dhe organet e pushtetit vendor. Objektivat kryesore janë:

- Sigurimi i normalitetit në grumbujt pyjorë, që të garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm dhe një përdorim racional duke siguruar prodhim maksimal nga grumbujt pyjor.
- Vlerësimi i pyllit si ekosistem multifunksional për ruajtjen e biodiversitetit dhe shtimit të të ardhurave në dobi të popullatës lokale.
- Intesifikimi i rritjes natyrore të grumbujve duke kryer ndërhyrjet e domosdoshme silvikulturore dhe duke vjelë në mënyrë racionale materialin drusor nga grumbujt pyjorë.
- Shtimi i sipërfaqes së mbulesës pyjore dhe sigurimi i ripërtëritjes natyrore nëpërmjet kryerjes së punimeve për sigurimin e gjeneratës së re të pyjeve në ato pjesë të territorit ku ajo mungon ose është dëmtuar.
- Përmirësimi përbërjes llojore, duke stimuluar përzierjet fletorë + halorë.
- Rritje e cilësisë së kërcellit dhe e kurorës së drurëve me synim përmirësimin e cilësisë e prodhimtarisë së grumbujve.
- Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës rrugore dhe rritja e sipërfaqes së grumbujve pyjorë të mirëshërbyer prej saj, mirëmbajtja dhe shtrirja optimale e rrjetit rrugor.
- Përpjekja maksimale për kontrollin e erozionit dhe mbrojtjen e burimeve ujore.
- Pakësimi i ndikimit negativ në gjendjen shëndetsore të pyjeve dhe ndalimi i veprimtarive të paligjshme në territorin pyjor dhe kullosor.

- Vlerësimi i mundësisë prodhuese të produkteve jodrusore pyjore dhe zbatimi i praktikave mirëmenaxhuese të vjeljes së tyre.
- Të krijojë mundësi për zhvillimin e turizmit natyror dhe rural në zonë dhe të evidentojë pjesët e teritorit me vlera të larta peisazhistike, historike, kulturore apo me vlera të veçanta tradicionale lokale.

Z. Ded Lleshi, Specialist Kadastrë & GIS në Sektorin e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave më tej thotë se, në ndërhyrjet silvikulturore janë parashikuar të kryhen, rrallime të tipit të parë dhe të dytë, prerje fitosanitare, pastrime, krasitje degësh në pisha të zeza në 233 ha, në trungishte e cungishte .Gjatë këtij 10-vjeçari janë parashikuar ndërhyrje gati në cdo parcelë pyjore, kjo për faktin që të vihet dorë në këta grumbuj me qëllim rritjen e prodhimtarisë së tyre në të ardhmen.

Në këtë ekonomi nuk parashikohen të kryhen punime rehabilitimi për rrugët pyjore, pavarësisht se kanë nevojë, por do të kryhen sistemime malore për stabilizimin e terrenit siç janë ndërtimi i pritave malore, gardheve teke dhe çifte, pasi e kanë të nevojshme këtë ndërhyrje.

Do të ndërtohen rreth 1570 m² prita me gardhe teke e çifte

Do të ndërtohen rreth 510 m³ prita me mure të thatë e brez betoni

Do të ketë mbi 162 ha krasitje të degëve të poshtme të pishave ne 1/3 e kurorës së tyre

Do të përmirësohen 21.3 ha kullota

Do të kryhen 578 ha pastrime në pyje

Do të kryhen 463 ha rrallime të tipit të parë, 1464 ha rrallime të tipit të dytë.



Z. Kristin Ndou, Kryetar i fshatit Qebik, përshëndet hartimin e planit të mbarështrimit për ekonominë pyjore Dardhë-Qebik dhe apelon për sa më shumë fonde për pyjet dhe kullotat për ti rigjeneruar ato dhe për ti mbrojtur.

Në emër edhe të banorëve të tjerë kërkojmë sistemimin e pyjeve dhe kullotave të zonës tonë, duke filluar nga pastrimi i bimëve të reja dhe duke pasë parasysh terrenin e thyer malor kërkojmë të bëhen prita malore.

Kërkojmë përmirësimin e pyjeve, të pastrohen degët dhe të sistemohen pyjet ashtu siç e keni thënë edhe në draft. Ky prezantim është i qartë dhe i shërben të gjithë komunitetit dhe mjedisit dhe ne jemi shumë dakord, mundësisht të hartohen edhe të tjerët.

Qazim Baftia, Kryetar i fshatit Flet:

Kemi nevojë për shumë vëmendje për pyjet për ti mbrojtur, sistemuar dhe për t'i shtuar ato përmes pyllëzimeve. Ai tha se ky plan 10-vjeçar i shërben të gjithë komunitetit pasi tregon realitetin dhe jep masa për zhvillimin e pyjeve.

Z.Gjovalin Prendi, Administrator i Njesisë Administrative Blerim:



Ne si komunitet mirëpresim hartimin e planit Dardhë-Qebik , është shumë e qartë se ky plan evidenton nevojat për ndërhyrje në pyje me investime dhe procesi i digjitalizimit do t'i shërbejë të gjithë Njesisë Administrative Blerim për menaxhimin e mirë të pyjeve dhe kullotave për 10 vitet e ardhshme. Kërkohet ndërtimi i pritave malore, Lufta ndaj krimbit të pishave, mbrojtje nga zjarri etj.

Z. Fran Dema, Përhëndet hartimin e planit të mbarështrimit Dardhë-Qebik nga specialistet përkatës. Është shumë e qartë se ky plan do jetë i disponueshëm dhe i aksesueshëm nga komuniteti për mbrojtjen, ruajtjen dhe shtimin e fondit pyjor dhe në këtë kërkojmë.

Z. Fadil Vela, Kryetar i fshatit Xath: Duke ju falenderuar për gjithë shpjegimet e projektit, ne kërkojmë të bëhet realitet ky projekt duke sistemuar dhe shtuar pyjet e bimësitë ashtu siç e thatë edhe ju dhe në këtë mënyrë mbrohemi edhe nga erozioni dhe gërryerjet e tokës nga shirat.

Gjithashtu kërkojmë sistemimin e pyjeve dhe kullotave, Pastrimin e dhe krasitjen e pyjeve, Shtimin e pyjeve dhe kullotave.



Takimi u mbyll me sukses duke marrë falenderime dhe përhëndetje nga pjesëmarrësit.

SEKRETAR PËR KËSHILLIN BASHKIAK

Naze SELIMAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

PËR:

- Z. HIL CURRI, KRYETAR I BASHKISË
- DREJTORINË E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE
- KËSHILLIN E BASHKISË FUSHË-ARRËZ

Përmbledhje e Rekomandimeve të konsultimit publik “ Mbi draftin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave Dardhë-Qebik”

Titulli i Projektaktit : “ Mbi draftin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave Dardhë-Qebik”.

Grupet që u konsultuan: Banorët e Njesisë Administrative Blerim, banorë të fshatrave Dardhë, Qebik, Truen, Blerim, Kulumri, Xath si dhe Kryetarë të fshatrave të përfaqësues të grupeve të ndryshme te interesit, etj.

Numri i pjesëmarrësve në konsultim : 18 persona, nga të cilët 2 gra dhe vajza (11%)

Numri i rekomandimeve: 20

Rekomandimet dhe kërkesat e dhëna nga qytetarët në takimin publik janë mbi:

Sistemimin e pyjeve dhe kullotave;

Pastrimin e dhe krasitjen e pyjeve;

Shtimin e pyjeve dhe kullotave.

Ndërtimin e pritave malore;

Lufta ndaj krimbit të pishave;

Mbrojtje nga zjarri.

SEKRETAR PËR KËSHILLIN BASHKIAK

Naze SELIMAJ



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTË PUBLIKE ME TEMË:
"Draft-Plani i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave Dardhë-Qebik"

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Besjana	Marku	Dardhë	Mësues/Këshilltar	
2.	Azemi	Dezha	Blerim	Planta	
3.	Fadil	Velaj	Xoth	Kryetari i Fshatit	
4.	Mukonen	Donat	Blerim	K/Fshat, Blerim	
5.	Isa	KADRI		P.A. Dardhë	
6.	Scerpiu	Mari	Blerim		
7.	Fet	Zeh	Blerim	teknik	
8.	Gjan	Demir	Blerim		
9.	ZIADA	GTARU	BLERIM	S/NE	
10.	AKBERTA	VEZAR	BLERIM	S/F	
11.	BESIM	GTARU	BLERIM		
12.	BILBIL	M. PARI	BLERIM		
13.	Shkelzen	Byla	Blerim		
14.	Shenit	Dervishi	Blerim		
15.	Hasim	Hashi	BLERIM		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTË PUBLIKE ME TEMË:
"Draft-Plani i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave Dardhë-Qebik"

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	SEFERIN	DERRI	BLERI	PA PUN	
2.	DAZIN	BARIN	BELIN	KRISTIANI	
3.	LEJFI	NOLLI	-U	ELIKRI	
4.	JULI	ICARDI	-U	P. SHOR	
5.	NOUE	MARI	-U	P. DRUFE	
6.	AZEN	DERVI	-U	P. SHOR	
7.	SHYRRI	BELI	BELIN	P. DRUFE	
8.	KRISTIN	NOLLI		Lry. Plakë	
9.	MUKAM	DERI	BELIN	P. DRUFE	
10.	SOKOL	VATA		ing.	
11.	DED	LLESHI	BLERIM	SPECIALIST	
12.	HAZE	SELIMAJ	F-ARRËZ	sekretore KB	
13.					
14.					
15.					